




RAPORTI I DYTË NGA MONITORIMI I CILËSISË SË DEBATIT NË KUVEND



KUVENDI NËN THJERRËZ

Përforcimi i debatit politik
dhe diskursit deliberativ

TETOR 2014



RAPORT NGA MONITORIMI I RAPORTIMI MEDIATIK PËR PUNËN E KUVENDIT (TETOR 2014)

Instituti për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe Instituti për Evropën Lindore dhe Qendrore dhe Ballkanin (IELQB), duke filluar nga qershori i vitit 2014 deri në mars të vitit 2015 e përcjellin nivelin e cilësisë së debatit në Kuvendin dhe raportimin e medieve nga puna e deputetëve. Monitorimi zhvillohet në kuadër të projektit “Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ” financiarisht i përkrahur nga Unioni Evropian. Gjatë periudhës së monitorimit do të përgatiten dhjetë raporte mujore për cilësinë e debatit në Kuvendin dhe për raportimin mediatik. Para jush është raporti i dytë i cili ka të bëjë me raportimin e 10 medieve kombëtare në periudhën nga 1 – 31 tetor të vitit 2014.

Qëllimi i monitorimit është që në mënyrë empirike të arrihet në njohuri se në çfarë masë janë mediet pjesë e procesit të deliberacionit në shoqërinë gjatë krijimit të politikave publike, përkatësisht në çfarë masë opinionit më të gjerë ja transmetojnë argumentet e prezantuara në diskutimet kuvendore.

Pas çdo muaji të monitoruar opinionit do të informohet përmes raporteve për gjetjet kyçe të monitorimit të medieve edhe nga debati në Kuvendin.

A.REZYME

Gjetjet kyçe në Raportin e dytë të monitorimit janë se në periudhën e vëzhguar nga 1 deri 31 tetor, gazetatat dhe televizionet në pjesë dominuese e kanë përmendur Kuvendin në kontekst të ngjarjeve më të gjera politike, kthyerjen e deputetëve të PDSH në Kuvend, bojkoti i opozitës të udhëhequr nga LSDM dhe procedura e marrjes së mandateve deputetëve të zgjedhur opozitar. Në mënyrë të konsiderueshme më pak është informuar konkretisht për debatet dhe argumentet e prezantuara në seancat plenare dhe të komisioneve.

Me këtë opinionit nuk është tërësisht i informuar për pjesën më të madhe të ngjarjeve në Kuvendin të cilat kanë të bëjnë me temat të cilat i shqyrtojnë deputetët dhe argumentet të cilat paraqiten në favor ose kundër zgjidhjeve ligjore.

Gazetat shumë më tepër se sa televizionet kanë botuar informacione në të cilat përmendet Kuvendi. Si burime të informacioneve në lidhje me Kuvendin më shpesh paraqiten deputetët, por vërehet se numri më i madh i teksteve dhe i kontributeve në këtë periudhë përmbajnë deklarata ose qëndrime vetëm të një opsioni politik. Me këtë rast, në pjesën më të madhe të teksteve me të cilat është prezantuar vetëm një opsion politik, burime janë deputetët nga shumica parlamentare ose deputetët të zgjedhur nga partitë opozitare, ndërsa në pjesë më të vogël janë deputetët nga shumica në pushtet.



B. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Monitorimi i medieve përfshin përcjellje të informacioneve të paraqitura në 10 medie kombëtare në të cilat deputetët dhe Kuvendi. Përcjellja i përfshin tekstet e botuara në gjashtë gazeta ditore nga të cilat katër janë në maqedonisht dhe dy në gjuhën shqipe. Nga kontributet televizive përcillen informacionet e transmetuara në emisionet qendrore informative në katër televizione kombëtare nga të cilat dy janë në gjuhën maqedonase, ndërsa dy janë në gjuhën shqipe. Me monitorimin janë përfshirë mediet vijuese:

Gazeta

- Dnevnik
- Utrinski vesnik
- Veçer
- Sloboden pečat
- Koha
- Lajm

Televizione

- Sitell
- Tellma
- Alsat-M
- RTM2 Programi në gjuhën shqipe

Në mediet e përmendura përcillen dhe analizohen informacionet në të cilat përmenden Kuvendi, deputetët dhe procedura ligjvënëse. Me këtë rast, në hulumtimin, si pjesëtarë të opozitës janë llogaritur edhe pjesëtarët e partive opozitare të cilët në zgjedhjet e fundit parlamentare morën mandate, por vendosën të mos i pranojnë. Në çdo tekst veç e veç dhe në çdo kontribut televiziv analizohen elementet kryesore përkatësisht zhanri, fokusi i informacionit, lloji, numri, pala dhe sheshtësia e burimeve.

V. KONTEKSTI POLITIK

Në pajtim me Kushtetutën dhe Kodin zgjedhor, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Njëqind e njëzet deputetë zgjedhen në lista proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh, ndërsa tre deputetë zgjedhen nga tre njësi zgjedhore në botën e jashtme. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill të vitit 2014, partia Organizata e brendshme maqedonase revolucionare – Partia demokratike për unitet kombëtar maqedonas (VMRO-DPMNE) fitoi 61 deputet, ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin e formon qeverinë, BDI fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë Opsioni qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (RDK).




Gjatë monitorimit në tetor, deputetët nga koalicioni më i madh opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), i cili fitoi 34 mandate, e bojkotuan punën e Kuvendit¹ përveç tre deputetëve të cilët i pranuan mandatet Pas 26 gushtit kur ndodhi incidenti në seancën e Komisionit për financa dhe buxhet, Kuvendin e bojkotuan edhe shtatë deputetët e Partisë opozitare demokratike e shqiptarëve² (PDSH). PDSH e përfundoi bojkotin e Kuvendit dhe nga 20 tetori deputetët e saj sërish u kyçën në punën e Kuvendit.

G. GJETJE NGA MONITORIMI

Ky raport i përfshin informacionet e transmetuara gazetareske që kanë të bëjnë ose që e prekin punën e Kuvendit në periudhën nga 1 deri 31 tetor. Gjithsej janë analizuar 103 tekste gazetareske dhe kontribute të botuara në gazetatat dhe të transmetuara në televizionet. Nga ato sipas

- llojit të medias: 85% janë në gazeta, ndërsa 15% në televizione
- gjuhës: 78% janë të botuara në mediet në maqedonisht, ndërsa 22% në gjuhën shqipe.
- nga tekstet e botuara në mediet e shtypura, 81% janë të botuara në gazetatat në maqedonisht, ndërsa 19% në gazetatat në gjuhën shqipe.
- Nga kontributet në televizionet, 60% janë të transmetuara në maqedonisht, ndërsa 40% në gjuhën shqipe.




¹Deputetët opozitare Roza Topuzovska Karevska nga Partia Liberale demokratike, Sollza Gërçeva dhe Lubica Buralieva nga LSDM vendosën ti pranojnë mandatet e deputetit të fituara në zgjedhje edhe përkundër vendimit të koalicionit opozitar për bojkot të punës së Kuvendit.

²PDSH pas mbajtjes së Kuvendit Qendror të partisë të mbajtur më 18 tetor vendosi të kthehet në Kuvend. Deputetët e PDSH nga 20 tetori sërish merr pjesë në punën e Kuvendit.




I. Zhanri i informacioneve

Informacionet gazetareske sipas karakteristikave të zhanreve në pjesën më të madhe, 50% kanë qenë të strukturuar si raporte përkatësisht vetëm vetëm informojnë për ngjarjet e ndërlidhura me Kuvendin. Nga tekstet dhe kontributet e monitoruara, 20% janë shkrime përkatësisht kanë elemente informative dhe analitike gjatë raportimit për ngjarjen, 25% janë lajme themelore në të cilat ka informacion të shkurtër nga ngjarja dhe 5% janë analiza dhe komente të ngjarjeve të caktuara. Kjo në krahasim me periudhën paraprakisht të monitoruar është zvogëlim i numrit të raporteve dhe rritje e numrit të lajmeve të shkurtëtra në të cilat ka vetëm informacione themelore për ngjarjen.




II. Fokusi i teksteve dhe të kontributeve

Monitorimi i përmbajtjeve të botuara në mediet në këtë periudhë tregon se në 45% nga tekstet e botuara dhe kontributeve të transmetuara në tetor Kuvendi vetëm përmendet ose vetëm përmendet, ndërsa vetë përmbajtja e informacioneve nuk ka të bëjë me ngjarje konkrete në shtëpinë ligjvënese ose punën e deputetëve. Kjo është për 6% më tepër se në periudhën e kaluar të monitoruar (19 qershor – 30 shtator). Në vendin e dytë me 31% janë tekstet dhe kontributet që kanë të bëjnë me punën e përgjithshme e Kuvendit gjë e cila është për 16% më tepër se sa në periudhën e kaluar të monitoruar. Në llogari të rritjes së informacioneve të botuara nga këto dy kategori në tetor në mediet e monitoruara është zvogëluar numri i informacioneve të botuara që kanë të bëjnë me debatin dhe argumentet e prezantuara në seancat kuvendore. Të tilla kanë qenë vetëm 11% nga informacionet për dallim të atyre 28% në periudhën e kaluar. Të dhënat nga analiza vënë në pah se në tetor Kuvendi më shpesh është përmendur në kontekst të ngjarjeve aktuale midis partive më të mëdha në shtet, ose më saktë, në kontekst të bojkotit të opozitës dhe fillimit të procedurës së marrjes së mandateve të deputetëve të zgjedhur nga opozita të cilat nuk i kanë pranuar mandatet.




Me këtë rast, mund të vërehet se mediet në gjuhën maqedonase në këtë periudhë në përgjithësi më tepër kanë transmetuar informacione në të cilat Kuvendi vetëm është përmendur ose informacione të cilat kanë qenë në lidhje në përgjithësi me punën e shtëpisë ligjvënëse. Mediet në gjuhën shqipe, ndërkaq, më tepër kanë transmetuar informacione të cilat kanë të bëjnë me incidentin³ në Kuvend që ndodhi më 26 gusht.

³Më tepër informacione për incidentin janë përfshirë në Raportin e dytë për cilësinë e debatit në Kuvend (gusht - shtator) http://www.idscs.org.mk/images/parliament-watchdog/VTOR_IZVESTAJ_SOBRANIE_avgust-septemvriMK.pdf




III. Numri dhe pala e burimeve

Në tekstet dhe kontributet e monitoruara në tetor ka rënë numri i burimeve të cilat janë konsultuar gjatë përpilimit, krahasuar me periudhën paraprakisht të monitoruar (qershor-korrik). Në 46% është konsultuar një burim, në 23% dy, në 15% tre, ndërsa më tepër se tre burime ka pasur në 5% të teksteve dhe të kontributeve. Në 9% nga përmbajtjet e botuara nuk ka burime.







Vërehet se në pjesën më të madhe të teksteve dhe kontributeve që kanë të bëjnë me Kuvendin burime më të shpeshta janë deputetët, përkatësisht të tilla janë burimet e cituara ose të konsultuara në 50% të rasteve. Me këtë rast, duhet të merret parasysh se në monitorimin si deputetë shënohen edhe burimet të cilët janë deputetë të zgjedhur, përkatësisht pjesëtarë të partive opozitare të cilët fituan mandate në zgjedhjet e fundit parlamentare, por deri tani nuk i kanë pranuar mandatet. Burime të dyta sipas numrit ose 32% janë parti politike të cilat kanë komentuar ngjarje të ndërlidhura me Kuvendin që është për të plota 20% më tepër se sa në periudhën e kaluar të monitoruar. Ndryshim ka edhe në atë që në përmbajtjet e monitoruara të medieve në tetor nuk është shënuar informacion në të cilin përmendet Kuvendi, ndërsa në të cilën si burime janë konsultuar anëtarë të Qeverisë. Në , në tetor më rrallë janë konsultuar ose të transmetuar burime nga organizatat civile dhe analistë nga institucione arsimore për dallim nga periudha paraprake.



Deputetë me emër dhe mbiemër si burime të informacioneve janë theksuar në 57% të përmbajtjeve të botuara në mediet të cilat kanë pasur të bëjnë me Kuvendin. Për dallim nga periudha paraprakisht e monitoruar, në tetor është rritur përqindja e informacioneve të botuara në të cilat është theksuar se burimet janë deputetë, por identiteti i tyre nuk është shpalosur.



Nëse analizohet sipas asaj të cilit opion i takojnë deputetët të cilët si burim kanë qenë të konsultuar në tekstet gazetareske dhe në kontributet rezultojn se mediet në tetor, në 66% të rasteve kanë konsultuar burime nga vetëm një palë politike. Me këtë rast, kësaj radhe është e kundërt krahasuar me periudhën paraprake të monitoruar (qershor – shtator). Mediet më shpesh kanë publikuar informacione në të cilat citohen ose transmetojnë deklarata dhe qëndrime të deputetëve aktiv ose të zgjedhur nga opozita, se sa nga shumica pushtetmbajtëse. Në tekstet dhe kontributet në të cilat janë konsultuar deputetë në 44% kanë qenë vetëm pjesëtarë të opozitës, në 22% vetëm të partive nga shumica pushtetmbajtëse, ndërsa në 34% janë konsultuar ose transmetuar qëndrime të deputetëve edhe të pushtetit edhe të opozitës. Kësaj radhe në informacionet e monitoruara nuk janë vërejtur raste në të cilat nuk është vënë në pah se cilit opion politik u takojnë burimet për dallim nga 7% në periudhën e monitorimit të kaluar.




IV. Rubrika


Sipas të dhënave nga monitorimi, 39% të teksteve dhe të kontributeve në të cilat është i përfshirë Kuvendi kanë qenë të paralajmëruara në faqet kryesore të gazetave ose në paralajmërimin e përgjithshëm të ditareve televizive, ndërsa në 61% nuk kanë fituar vend të tillë. Në raport me rubrikat,



këto informacione më shpesh, në 93% janë botuar në faqet e para të gazetave dhe në pjesët e para të ditereve si “Makedonija”, “Politiko”, “Aktuellno” ose ngjashëm. Informacionet që kanë të bëjnë me Kuvendin shumë më rrallë, në 2% janë botuar në rubrikat të dedikuara ekonomisë dhe biznesit për dallim prej 10% në periudhën e kaluar. Në kollumna dhe komente në 5%.



Në përmbajtjet e këqyrura mediatike në tetor të vitit 2014 në 73% të teksteve dhe të kontributeve është theksuar, ndërsa në 18% nuk është theksuar autori i përmbajtjes së botuar në të cilën përmendet Kuvendi. Ajo është për 9% më tepër se sa në periudhën paraprake kur në 18% të informacioneve nuk ishte i theksuar autori.





D. KONKLUZA:

- Mediet në tetor të vitit 2014 i kushtuan vëmendje e pa konsiderueshme debatit dhe argumenteve të prezantuara në seancat kuvendore.
- Kuvendi në tetor të vitit 2014 më shpesh është përmendur në kontekst të gjendjes më të gjerë politike në shtet, raportet midis partive, bojkoti i opozitës dhe kthimi i deputetëve të PDSH në punën e Kuvendit.
- Mediet në gjuhën maqedonase në mënyrë shumë më të konsiderueshme kanë informuar për Kuvendin sesa mediet në gjuhën shqipe. Gazetat, njëlloj si në periudhën paraprake, më tepër se sa televizionet raportojnë për ngjarje të ndërlidhura me Kuvendin.
- Në një pjesë më të madhe janë botuar dhe transmetuar përmbajtje të cilat kanë të bëjnë me Kuvendin si burime paraqiten deputetë, por me këtë rast më shpesh vetëm nga një opion politik, ndërsa më rrallë janë cituar ose konsultuar burime edhe nga shumica edhe nga opozita bashkë.
- Në tetor të vitit 2014 në përmbajtjet e transmetuara në të cilat janë konsultuar burime nga vetëm një opion politik shumë më shpesh paraqiten deputetë nga opozita se sa nga shumica.
- Përmbajtjet që kanë të bëjnë me Kuvendin në pjesën më të madhe janë publikuar në formë të raporteve informative, ndërsa shumë më rrallë kanë pasur elemente analitike.
- Mediet edhe shumë më rrallë se sa në periudhën paraprake të monitoruar kanë konsultuar organizata civile ose qytetarë kur kanë raportuar për tema të ndërlidhura me Kuvendin.

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit publik dhe diskursit deliberativ” është i financuar nga Unioni Evropian.

Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të Unionit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas Civilis” – Shkup *IDSCS) dhe në kurrfarë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shfaq pikëpamjet e Unionit Evropian.